

VENDIM
Nr. 51, datë 7.12.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN DHE
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE
JOBANKA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 1, datë 17.1.2013, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas pikës 1 të nenit 16, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“1/1. Përjashtohen nga zbatimi i shkronjës “e”, të pikës 1, të këtij neni, institucionet financiare të mikrokredisë dhe subjektet financiare jobanka, që blejnë kredi me probleme, të cilat nuk lejohen të kryejnë veprimtarinë si agjent në sigurime.”;

b) Në formularin nr. 9, pika 10, togfjalëshi “duke përfshirë edhe agjentët dhe degët”, zëvendësohet me togfjalëshin “duke përfshirë dhe degët”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko